



## **KËSHILLI I EVROPËS PREZANTON NJË INFORMATË TË AZHURNUAR TË AKTIVITETEVE TË KOMISIONIT IMPLEMENTUES TË RINDËRTIMIT**

Këshilli i Evropës me mbështetjen e Komisionit Evropian dhe të Agjencionit Evropian për Rindërtim është nikoqir i hapjes zyrtare të ekspozitës së punimeve të Komisionit Implementues të Rindërtimit, që është përgjegjës për rindërtimin e 34 tërësive serbe ortodokse të dëmtuara apo të shkatërruara në marsin e vitit 2004.

Ekspozita synon ngritjen e vetëdijes publike për punët që janë duke u ndërmarrur gjithandej nëpër Kosovë, dhe të promovoj mbështetjen për projektin i cili përmbajtësisht është financuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (afërsisht 6 milion euro), me një kontribut të Komisionit Evropian dhe AER prej 2.4 milion eurosh.

Pritet që punët kryesore të kryhen deri në shkurt të vitit 2008 duke ua dhënë mundësinë priftërinjve që të kthehen në kishat e tyre dhe me një mbështetje nga bashkësitë vendore dhe nga komuna, të riintegrohen në një jetë normale të përditshme.

Projekti ka qenë i suksesshëm vetëm falë përkushtimit dhe bashkëpunimit të Kishës Ortodokse Serbe, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Institutit për Mbronjtjen e Monumenteve të Beogradit dhe Prishtinës respektivisht. Secili institucion luan një rol kritik në këtë proces dhe përfaqësimi i tyre kolektiv në KIR, i kryesuar nga Këshilli i Evropës, ka gjeneruar një mekanizëm përmes të cilit e tërë trashëgimia kulturore në Kosovë ka arritë të rehabilitohet dhe njëkohësisht është promovuar pjesëmarrja shumëetnike në të gjitha nivelet e procesit, nga menaxhmenti deri te puna praktike.

KIR ka shumë partnerë të involvuar përfshirë UNMIK-un, komunat, IMM-të dhe OJQ-të dhe përkrahet nga një këshill ndërkombëtar ekspertësh i përbërë nga profesionistë të fushës së arkitekturës, arkeologjisë, inxhinierisë ndërtimore dhe të konservimit të pikturave murale nga Spanja, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia respektivisht.

Suksesi përfundimtar i KIR varet nga vullneti i bashkësive për të pranuar riintegrimin e kishave në shoqëri. Ato janë pjesë e pejsazhit, pamjes së rrugës dhe përfaqësojnë një pjesë të historisë së Kosovës, të kaluarën dhe të tashmen, që duhet të respektohet dhe të pranohet. Trashëgimia jonë e përbashkët evropiane është poaq e ndryshme sa edhe e ngjashme – ne të gjithë e kemi për detyrë që ta mbrojmë trashëgiminë tonë kulturore sikurse edhe diversitetin dhe identitetin tonë kulturor tash dhe për brezat e ardhshëm.

Prishtinë, 24.09.2007.